



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 05.08.2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš**
**02 Nr. Br. 400/01-16376/24
05.08.2024
Dragash - Dragaš**

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë për Buxhetin e vitit 2025

I mbajtur më 01.08.2024 (e enjte)

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë për Buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2025 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 17.07.2024.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-shqip.pdf>

Bosnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-bosnjakisht.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/tXDgwzYBgvSjk63B/>

Bosnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/YSyDiSieUgUYH7h3/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Degjimi-Opoje-Scan.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:25** dhe ka përfunduar në **ora 11:38**.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **21 pjesëmarrës**, prej tyre **16 meshkuj** dhe **5 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës, **Bexhet Xheladini**, i cili i ka falënderuar për pjesëmarrjen të gjithë të pranishmit. Siç e dini, në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Financimin e Pushtetit Lokal, si dhe bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, komunat janë të obliguara që të mbajnë debate publike me qytetarë për përgatitjen e Buxhetit për vitin 2025. Siç jeni të informuar, unë si kryetar i Komunës e kam formuar Grupin Punues për përgatitjen e Buxhetit, i cili është urë lidhëse në mes të kryetarit dhe grupeve të ndryshme të interesit, në mënyrë që ne të jepim sa më shumë informata për buxhetin, si dhe sa më shumë kërkesa të marrim nga grupet e interesit. Siç e dini, ka afër dy muaj që KAB-in e kemi miratuar, dhe tani presim që Qeveria e Kosovës të na kthejë Qarkoren e Dytë Buxhetore. Besojmë se kjo Qarkore nuk do të ketë ndryshime, në krahasim me KAB-in që e ka miratue Asambleja Komunale. Nëse do të ketë ndryshime, ne obligohemi që përmes mjeteve të informimit, përmes faqeve tona zyrtare të ju informojmë për ndryshimet që ka pësue KAB-i. Sa për informimin tuaj, unë do të ju njoftoj për Buxhetin e viti 2025, Buxheti për vitin 2025 do të jetë **12,872,214 euro**; nga këto, gati gjysma shkon për paga **5,844, 424 euro**; Mallra dhe Shërbime **1 milion e gjysmë euro**; Shërbime Komunale dhe Shërbime Publike **gjysmë milion euro**; Subvencione **400 mijë euro**; Investime Kapitale **4 milionë e 700 mijë euro**. Për fillim, unë dhashë disa informata të shkurta për Buxhetin. Këtu pranë mesh i kam edhe të dy nënkyetarët e Komunës, nëse dojnë me e marrë fjalën ju, të nderuar pjesëmarrës.

Resul Fetahu: I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm! Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë dëgjim buxhetor dhe presim propozimet tuaja për Buxhetin. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën lidhur me Buxhetin e viti 2025? Dje, ne kemi mbajtur një debat publik me Gra dhe Vajza. Ato kanë qenë shumë aktive dhe ka pas 7-8 diskutantë të cilët kanë dalë në foltore dhe i kanë parashtrue dhjetë kërkesa. Besoj se shumica dërmuese e këtyre kërkesave do të inkorporohen në Buxhetin e viti 2025. Atëherë, nëse dikush prej jush do ta marrë fjalën, urdhëroni!

Jeton Qengaj, OJQ “Avoko”: Përrshëndetje për të gjithë! Kryetar, shumë shkurt. Është një kërkesë që është edhe me ligj për me u zbatue, edhe në disa komuna u bo. Ekziston një nën kod buxhetor për Rini, i cili ndahet fondi i rinisë prej kulturës dhe sportit. Kjo është shumë mirë, se në shumicën e rasteve – edhe pse jam në këtë pjesë dhe më takon për me folë – po ne fundi i fundit nuk kemi edhe shumë nevojë për fond prej Komunës, sepse.... por është nën kod buxhetor për Rini, i cili ndahet buxheti i Komunës prej kulturës edhe sportit. Ne e kemi përgatit, po më duket në vitin 2017, i kemi

krye të gjitha procedurat po nuk i kanë marrë parasysh me e përfundue. Ky kod duhet të bëhet, foni i Rinisë duhet me u nda prej kulturës dhe sportit, se kohëve të fundit pak rinia është duke u shkelë. Unë e di që keni pak probleme, edhe sporti ka nevojë shumë, edhe kultura njëjtë ka nevojë shumë. E kuptoj edhe të hyrat buxhetore që i ka Komuna e Dragashit, shumë të vogla të ardhurat vetanake. Nuk do të thotë veç një organizate, Avokos, sepse unë nuk i shoh organizatat konkurrente, por i shoh bashkëpunuese. Është shumë mirë të gjitha organizatat bashkërisht me u çue me punue mirë për këtë vend, edhe me e pas gjatë dhënies së fondit, ekziston edhe ai ligji që me ia kqyr sa aktivitetet, edhe me i tregue që 20% paga ime s'mundet një fond me u dhënë e një ditë aktivitet. Por të paktën me bo pak më gjërësish. Kështu që, deri më sot ne jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin dhe punën, por qeky nënëkodi i Rinisë është shumë i mirë që ndahet buxheti i rinisë prej tjerëve. Rinia e Dragashit ka nevojë për shumë aktivitete e kërkesa, tash nuk po hyjmë rend se na duhet shumë kohë për me i diskutue. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit shumë! Është një propozim me vend. Edhe pse nuk e kemi nënëkodin, ne për rrininë bëjmë thirrje vazhdimesht, për çdo vit, prej se kam ardhë në pushtet, Këtu e kemi edhe ZKF-në, i cili, nëse ekziston mundësia me u bo një nënkok i tillë, ne mujm me e bo. Nëse na lejon ligji, nuk është problem. Më mbetet të jap edhe një informatë, të gjitha thirrjet publike që bëhen, ato duhet të bëhen patjetër në bazë të të hyrave vetanake. Ne jemi Komuna e parë në Kosovë, e cila 90% të të hyrave vetanake i shfrytëzojmë për rini, sport, kulturë, OJQ, për aktivitete të ndryshme. Nga 500 mijë euro të hyra vetanake, 400 mijë i ndajmë për thirrje publike. Po të kishim ne të hyra vetanake sikur Prizreni, me miliona, sigurisht se ne prapë qet 90%-shin e mjeteve i ndajshna për rini, sport edhe kulturë. Problemi është që ne jemi Komunë e varfér, me pak të hyra vetanake. Atëherë, nëse nuk ka pyteje të tjera, ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen në këtë dëgjim buxhetor! Falënderoj përfaqësuesin e OSBE-së për prezencën e tij, përfaqësuesit e OJQ “Avoko” dhe të gjithë të tjerët! Ju faleminderit!

Linjet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-himore-te-regionit-te-opojes-me-ojq-biznese-fermere-te-rinj-dhe-pensioniste/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/kauMVZVvcPkwemWv/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/pwCebvoyDR17Drkr/>

SHTOJÇË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 01.08.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESEMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR
 ME BANORË TË FSHATRAVE TË REGJIONIT TË OPOJËS, ME OJQ,
 BIZNESE, FERMERË, TË RINJ DHE PENSIONISTË BUXHETIN E
 VITIT 2025**

**LISTA UČESNIKA NA SASLUŠANJE BUDŽETA SA STANOVNICIMA
 SELA REGIONA OPOLJA, SA NVO, PREDUZEĆIMA,
 POLJOPRIVREDNICIMA, MLADIM LJUDIMA I PENZIONERIMA ZA
 BUDŽET ZA 2025 GODINU**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M	F	Nënshtkrimi Potpis
1	Dreni Myrllezumi	Zaplluxhe	KOSOVAR	✓		
2	Shokra Skenderaj	Bucat	—	✓		Lumë
3	DRITON Zefnuuuuu	BLAG	—	✓		Dafur
4	Zivnay Gjeli	Bellubrad	—	✓		Jeliaz
5	LJHNITA PIRAJ	Plavë	shq	✓	✓	Suh
6	Geena Richards	Dragash	American	✓		Geena
7	Elisa Rashihi	Dragash	Kosovare	✓		Elisa
8	Icton Renyej	Dragash	Kosovar	✓		Icton
9	Semina Misli	Dragash	Kosovare	✓		Semina
10	Ajma Glengaj	Dragash	Kosovar	✓		Ajma
11	Veton Haxhi	Zaplluxhe	Kosovare	✓		Veton
12	BEHAR SELMANI	KUK	KOSOVARË	✓		Behar
13	SUAD TOSUNI	DRAGASH	KOSOVAR	✓		Suad
14	Burim Aliu	Bellubrad	Shqiptar	✓		Burim
15	Burim Xhaferli	Bellubrad	Shqiptar	✓		Burim
16	Zekir Zeceli	Dragash	Roskuk	✓		Zekir
17	Nuro Ismaili	Rajca	Kosovar	✓		Nuro
18	Osmandin Feruni	Brod	Bosnjak	✓		Osmandin
19	Sirhan Bajrami	Brod	Bosnjak	✓		Sirhan
20	Ramadan Ahmeti	Shoqia	Shqiptar	✓		Ramadan
21	Resul Edaba	KUK	Shqiptar	✓		Resul
22	REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA Komuna e Dragashit Opština Dragaš					

02 Nr.Br. 900/01-163 76/24
 01.08. 2024
 Dragash - Dragaš

